REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR SEMAN

ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BASENIT LUMOR SHKUMBIN-SEMAN
Nr. 274 Prot.
Datë, më 04.06.2026

# VENDIM

**Nr.9, datë 28.05.2026**

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME TEKNOLOGJIKE, TË SUBJEKTIT "ORHAN" SH.P.K, ME VENDNDODHJE: RRUGA "KORCË-BILISHT, KM 9", NJ. ADM POJAN, BASHKIA KORCË.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore" i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Seman,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime teknologjike, të subjektit "ORHAN" sh.p.k, me vendndodhje: Rr: "Korcë-Bilisht, km 9" Nj. Adm Pojan, Bashkia Korcë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

   Vendndodhja e burimit ujor **(pus-shpimi)**:

   - X= 572464.43
   - Y= 4507021.17
   - Z= 833 m

   - Sasia e ujit që jepet në përdorim : Q= 2 l/sek

   - Qëllimi i përdorimit : Për qëllime teknologjike.

- Thellësia e pus-shpimit: 100 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 40 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

  X= 572443.6; Y= 4507014.5; Z= 832 m

- Prurja që shkarkohet: Q= 2 l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBL SEMAN**

**ANDUEL XHINDI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I BASENIT LUMOR - SEMAN